



**PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2023**  
**ME ZGJEDHJE – SESIONI I**  
**SKEMA E VLERËSIMIT**

**LËNDA: FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI**

**Pyetjet me alternativa**

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	D	D	B	C	A	A	D	C	C	D
Pyetja	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29
Përgjigja e saktë	D	A	C	A	C	B	B	B	A	B

**Pyetjet me zhvillim**

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

**Sociologji**

**Pyetja 11**                      **2 pikë**  
**Model përgjigjeje**

Normat kulturore- Kanë traditë më të gjatë në shoqëri dhe janë më të larmishme; Ndryshojnë shumë ngadalë; Përcaktohen shoqërisht për të përcaktuar kritere në aspektin etik (folkuej); Kanë sanksione shoqërore kur nuk respektohen; Respektohen në saj të vullnetit të secilit.

Normat ligjore- U krijuan kur u themeluan shtetet; I përshtaten kohës ndaj ndryshojnë shpejtë; Janë kompetencë e organeve shtetërore; Kanë sanksione ligjore kur nuk respektohen, p.sh moret; Kanë fuqi detyruese për respektim.

**2 pikë** nëse shpjegon dy normat;  
**1 pikë** nëse shpjegon një normë;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12**                      **2 pikë**  
**Model përgjigjeje**

Moshë e trazuar- adoleshentët priren të konfliktohen me të tjerët. Studime sociologjike tregojnë se adoleshentët përjetojnë mosmarrëveshje me prindërit, mësuesit shumë shpesh.

Paqëndrueshmëria përmes kontradiktave- adoleshenca konsiderohet si një periudhë e paqëndrueshmërisë në mendime, përjetime dhe sjellje. Paqëndrueshmëria në këtë periudhë lidhet edhe me mesazhet kontradiktore me të cilat përballen adoleshentët. Në këtë periudhë gjithashtu ndodhin ndryshime të shpejta fiziologjike që lidhen me pubertetin si pjekuria seksuale dhe aftësia për riprodhim.

- 2 pikë** nëse shpjegon dy aspekte;  
**1 pikë** nëse shpjegon një aspekt;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13** **3 pikë**  
**Model përgjigje**

- Shmangia e çdo forme dhune, si dhunë fizike apo çdo formë e abuzimit seksual;
- Tejkalimi i shtresimit gjinor që kufizon mundësinë e vajzave për të përparuar në karrierë apo për t'u trajtuar me pagë të njëjtë për punë të njëjtë;
- Përkrahja e vajzave për të vendosur vetë mbi riprodhimin, abortin.

- 3 pikë** nëse përcakton tre synime;  
**2 pikë** nëse përcakton dy synime;  
**1 pikë** nëse përcakton një synim.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 14** **3 pikë**  
**Model përgjigje**

Marrëdhënia me norma kulturore të caktuara – Vlerat dhe normat kulturore ndryshojnë nga njëra shoqëri në tjetrën, për pasojë dhe përcaktimi i deviancës.

Rrethanat shoqërore – Një veprim mund të karakterizohet si deviant ose jo përcaktuar edhe nga rrethanat e veçanta të zhvillimit të shoqërisë.

Pozita shoqërore e individit ose grupit shoqëror që e kryen sjelljen deviante – klasa shoqërore, statusi, pozicioni të cilit iu përkasin.

Ndryshime në rrjedhën e kohës - Në çdo shoqëri kuptimi për deviancën ndryshon në rrjedhën e kohës.

- 3 pikë** nëse shpjegon tre faktorë;  
**2 pikë** nëse shpjegon dy faktorë;  
**1 pikë** nëse shpjegon një faktorë;  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15** **2 pikë**  
**Model përgjigje**

- 1) -Rëndësia e asimilimit qëndron në përshtatjen me kulturën e vendit pritës. Përvetësimi i sistemit normativ, vleror, besimeve, qoftë plotësisht ose pjesërisht lehtësojnë jetesën e anëtarëve të pakicave në kulturën sunduese të shoqërisë.  
 -Përshtatja e praktikave me kulturën e vendit pritës ka një efekt pozitiv në rritjen e sigurisë, duke qenë se pakicat e ardhura përshtasin mendësitë dhe sjelljet me atë çka standardet e kulturës sunduese kanë vendosur për bashkëjetesë.  
 -Krijon më shumë mundësi për punësim, duke qenë se kanë mësuar gjuhën e vendit pritës, vlerat dhe normat më të rëndësishme për bashkëjetesë.  
 -Në disa raste ndikon në përmirësimin e shëndetit, si një mirëqenie e komponentëve përkatës, duke inkurajuar disa praktika që janë më të dobishme dhe krijojnë mirëqenie. (largim nga praktika të pashëndetshme si: gjymtimi seksual, aborti përzgjedhës, martesat e hershme etj.)  
 -Forcon unitetin, përbushja e qëllimeve të përbashkëta ndihmon në angazhimet që lidhen me përmirësimin e komunitetit si vullnetarizmi, etj.  
 -Etj.
- 2) -Aspekt negativ mund të jetë detyrimi për ndryshime të sjelljeve, referuar legjislacionit. (Shembulli i SHBA-së për të asimiluar indianët e Amerikës pa marrë parasysh kulturën e tyre)  
 - Detyrimi në disa raste për të ndryshuar identitetin. Detyrimi për të ndryshuar emrin, mund të jetë një praktikë negative e përdorur forcërisht.  
 -Humbja e traditës familjare. Përfshirja në një rutinë të re të stilit të jetesës mund të ndikojë që të zbehen apo humbin traditat, ritet e kulturës nga vjen. Megjithatë nëse dikush merr vendimin të pranojë një kulturë të re ose jo, kjo duhet të lidhet me zgjedhjen personale.

- Venitet (rrëgjohet) diversiteti i identiteteve kulturore kombëtare. Kufizimi i perspektivave të tjera, duke inkurajuar “njëllojshmërinë” zbeh rolin e kulturave të tjera, duke cenuar multikulturalizmin.
- Etj.

- 2 pikë** nëse dallon dy aspekte;
- 1 pikë** nëse dallon një aspekt;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 16 2 pikë

#### Model përgjigje

Uniteti shoqëror-realizimi i ritualeve fetare së bashku, forcon lidhjet dhe zhvillon solidaritetin e një grupi shoqëror. Cermonitë kolektive bëjnë që anëtarët e komunitetit fetar të njihen e miqësohen me njëri-tjetrin. Krijohet tolerancë dhe harmoni midis njerëzve.

Kontroll shoqëror- besimet fetare ushtrojnë ndikimin e tyre në mënyrë që të zbatohen me korrektësi normat dhe vlerat që mbeshtesin, veçanërisht ato që konsiderohen si më të nevojshme për mbarëvajtjen e shoqërisë.

- 2 pikë** nëse shpjegon dy funksione;
- 1 pikë** nëse shpjegon një funksion;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 17 2 pikë

#### Model përgjigje

Në zonat urbane, njerëzit priren të kenë më pak lidhje personale dhe marrëdhënie me të tjerët sesa në komunitetet rurale, pra ka një anonimitet të shtuar. Kjo është pjesërisht për shkak të madhësisë dhe dendësisë së madhe të popullsisë urbane, gjë që mund ta bëjë të vështirë për individët të krijojnë rrjete sociale të ngushta. Për këtë arsye ata shpesh janë mospërfillës ndaj njëri-tjetrit.

Stili i jetës urbane shpesh përfshinë më shumë lëvizshmëri të njerëzve që lëvizin brenda dhe jashtë qytetit më shpesh, gjë që mund të kontribuojë më tej në një ndjenjë shkëputjeje dhe në shkallë të ndryshme po e humbasin ndjenjën e bashkësisë.

Diversitet më i madh- Zonat urbane priren të jenë më të larmishme për sa i përket racës, përkatësisë etnike, kulturës dhe mënyrës së jetesës sesa zonat rurale.

Toleranca- diversiteti mund të çojë në tolerancë dhe kuptim më të madh të perspektivave dhe mënyrave të ndryshme të jetesës. Stili i jetesës urbane shpesh përfshin ekspozimin ndaj një game më të gjerë njerëzish dhe idesh, të cilat mund të jenë edhe stimuluese dhe sfiduese. Qytetarët urbanë mund të kenë gjithashtu qasje në një gamë më të gjerë diversiteti kulturor, arsimor.

Ritmi i lartë i jetës bën që banorët e zonave urbane të shpërfillin informacionet e tepërta dhe kjo shpesh mund të interpretohet si indiferentizëm, megjithatë kjo nuk do të thotë se ata janë të pandjeshëm.

Etj.

- 2 pikë** nëse vlerësojnë dy karakteristika;
- 1 pikë** nëse vlerësojnë një karakteristikë;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 18 3 pikë

#### Model përgjigje

- Lëvizjet mund të kenë qenë shumë të suksesshme për të realizuar qëllimin, për këtë arsye nuk kanë më pse të vijojnë.
- Këto lëvizje mund të pësojnë rënie pasi krijohen konflikte e përçarje nga paaftësia e udhëheqjes.
- Një arsye tjetër mund të jetë korruptimi i udhëheqjes. Në këtë formë braktiset qëllimi kryesor i lëvizjes.
- Lëvizjet shoqërore mund të pësojnë rënie edhe nën presionin e masave kufizuese dhe dhunës që mund të ushtrojnë organet e shtetit për të mbrojtur interesat.

- 3 pikë** nëse analizon tre aspekte;
- 2 pikë** nëse analizon dy aspekte;
- 1 pikë** nëse analizon një aspekt;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 19 3 pikë

#### Model përgjigje

- Ndërthurin grup pyetjesh që janë të njëjta për të gjithë të intervistuarit me pyetje të lira.
- Formulojnë pyetjet e lira të përshtatura sipas veçorive të secilit të intervistuar.
- Janë të përshtatshme kur përdoren për të realizuar intervista në një shkallë të gjerë pasi ndihmon në tërheqjen e mendimeve individuale në mënyrë të hollësishme.
- Janë të përshtatshme pasi mundësojnë standardizimin në nivel të kënaqshëm

**3 pikë** nëse përcakton tri karakteristika;

**2 pikë** nëse përcakton dy karakteristika;

**1 pikë** nëse përcakton një karakteristikë;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

## Filozofi

### Pyetja 30 2 pikë

#### Model përgjigje

Virtetet e moralit: lidhen me zakonet dhe sjelljen e njeriut përgjatë jetës, ato nuk janë te individi për nga natyra, pra nuk janë prej lindjes. Virtytin Aristoteli e lidh me “mesin e artë”, që do të thotë të zbulojë masën e duhur përtej mungesës dhe tepërisë. Realizimi i këtyre sjelljeve vjen si rezultat i kontrollit racional mbi pasionet.

Lumturia: lumturia për Aristotelin është rruga e shpirtit drejt virtytit. Njeriu mund ta arrijë lumturinë duke jetuar në ekuilibër dhe t'i përmbahet rregullit të “mesit të artë”, larg pasioneve si lakmia, urrejtja, etj.

**2 pikë** nëse përshkruan dy koncepte;

**1 pikë** nëse përshkruan një koncept;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 31 3 pikë

#### Model përgjigje

- Sofistët analizonin në mënyrë kritike mësimet e fesë dhe moralit, për këtë arsye kritikët e gjykuan se në këtë mënyrë po ndikonin negativisht në edukimin e të rinjve.
- Retorika dhe mësimi saj sillte riskun për të përdorur argumentet si formë bindje për çështje të padrejta. Kjo formë ndikimi përmes aftësisë debatuese favorizonte individë të veçantë.
- Edukimi i tyre i largohej imazhit të misionit të filozofit që synon të vërtetën dhe lidhej më shumë me interesin për të fituar para, përmes pagesa nga nxënësit e tyre.

**3 pikë** nëse shpjegon tri kritika;

**2 pikë** nëse shpjegon dy kritika;

**1 pikë** nëse shpjegon një kritikë.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 32 3 pikë

#### Model përgjigje

- Vetëpërmbytja dhe pritja me qetësi e fatit, madje edhe e lumturisë.
- Qëndrim i matur ndaj të pashmangshmes në jetë, duke kontrolluar sjelljen e tyre ndaj ngjarjeve që nuk mund të kontrollohen.
- Realizimi i një jete të urtë dhe të kontrolluar. Kontrolli i pasioneve të trupit dhe shtypja e tyre nga arsyeja, shpirti racional. Gjendja ideale është mungesa e pasioneve, pasi pasionet janë ekuivalente me gjykimin e gabuar.
- Njeriu ka forcën e brendshme dhe në momentin që ai e gjen atë mund të arrijë qetësinë e më pas lumturinë. Përdorimi i logjikës e ndihmon njeriun të kuptojë ligjet e natyrës, të përballet dhe të përshtatet duke arritur qetësinë.

- Mbajtja e një qëndrimi indiferent dhe të mos biem pre e ndjenjave negative si xhelozia, urrejtja, zilia.
- Liria qetësia dhe lumturia e njeriut arrihet kur kontrollojnë pasionet. Shpërfillja ndaj bukurisë ose shëmtisë, sëmundjes ose shëndetit, pasurisë ose varfërisë.
- Përmes kërkimit të të mirës si urtësia, drejtësia, guximi.
- Mësimi dhe aftësimi i njeriut për të jetuar në harmoni me natyrën dhe arsyen.
- Nënshtrimi dhe bindje ndaj të përkryerës supreme, duke iu bindur asaj që ka parashikuar arsyeja hyjnore.
- Shpirti është unik dhe racional.
- Etj.

**3 pikë** nëse shpjegon tri drejtime;

**2 pikë** nëse shpjegon dy drejtime;

**1 pikë** nëse shpjegon një drejtim;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 33

**4 pikë**

#### Model përgjigje

- Në qendër vendoset autoriteti i njeriut dhe besimi në arsyen e tij. Ndryshe nga periudha e Mesjetës që në qendër kishte autoritetin e kishës dhe adhurimi ndaj Zotit.
- Zhvillimi i shkencës moderne me metoda empirike, ndryshe nga periudha e Mesjetës në të cilën shkencë mbështetej në dogmat fetare.
- Pasqyrim i humanizmit në filozofi në periudhën e Rilindjes, ndërsa në Mesjetë filozofia ishte në shërbim të teologjisë.
- Kozmosi perceptohej i pafund, me Diellin në qendër. Ndërsa në periudhën e Mesjetës, universi perceptohej i kufizuar, i krijuar nga Zoti, me në qendër Tokën.
- Arti, filozofia, kultura humaniste, kultivuan optimizmin dhe individualizmin. Në Mesjetë, arti dhe kultura ishin në shërbim të fesë, në qendër Zoti dhe shenjtoret.
- Etj.

**4 pikë** nëse shpjegon katër drejtime;

**3 pikë** nëse shpjegon tri drejtime;

**2 pikë** nëse shpjegon dy drejtime;

**1 pikë** nëse shpjegon një drejtim;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 34

**3 pikë**

#### Model përgjigje

- Shteti i garanton njeriut disa të drejta duke i shtyrë ata të heqin dorë (të delegojnë) nga privilegjet dhe dëshira e pakufijshme. Kontrata është një marrëveshje mes njerëzve, për t'i dhënë disa të drejta një sovran, pushteti, i cili i siguron ato përmes ligjit.
- Për të garantuar jetën, njerëzit krijojnë shtetin si garantues të saj. Në këto kushte shteti ka autoritetin për të ndëshkuar.
- Shteti garanton respektimin e kontratës sociale dhe ka autoritetin të ndëshkojë njerëzit që e shkelin atë.
- Shteti shërben si mënyrë për të zvogëluar mosmarrëveshjet, ndarjet brenda shoqërisë.
- Krijimi i kontratës prodhohet prej frikës së njerëzve dhe përforcohet nga kjo frikë ndaj autoritetit suprem drejtuar nga "Leviatani i madh".
- Shteti është një ruajtës i paqes së shoqërisë, duke parandaluar luftën civile.
- Etj.

**3 pikë** nëse argumentojnë tri veçori;

**2 pikë** nëse argumentojnë dy veçori;

**1 pikë** nëse argumentojnë një veçori;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 35**  
**Model përgjigje****3 pikë**

Tezë – nënkupton logjikën (koncepti përcakton vetveten); ideja në vetvete, trajton mendimin e kulluar, paraqitje e shpirtit absolut në gjendje të kulluar; shembulli: një farë gruri hidhet në tokë (teza); Në konceptin e shtetit, individi në shoqëri vjen me gjithë nevojat vetjake.

Antitezë – nënkupton mohimin e tezës; Ideja jashtë saj; shpirti objektiv; filozofia e natyrës; shembulli: nga fara mbin një kalli që nuk është i njëjtë me farën. (antiteza); Në kuptimin e shtetit, individi bazuar në dashurinë mes individëve, krijon familjen duke jetuar e bashkuar me të tjerët. (mohimi i dytë).

Sintezë - mohimi i mohimit të tezës; lidhet me shpirtin absolut; ideja që rikthehet në vetvete; filozofia e shpirtit; shembulli: ky kalli zhvillohet dhe jep fara të reja, që nuk janë fara të vjetër. (sinteza). Në konceptin e shtetit, krijohet bashkimi i individëve dhe nevojave të tyre. (mohim i dyfishtë).

**3 pikë** nëse shpjegon tre elementë;

**2 pikë** nëse shpjegon dy elementë;

**1 pikë** nëse shpjegon një element;

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---